

## ABSTRAKT

Koordinimi i të drejtës së bashkimit familjar të shtetasve të shteteve të treta, ligjërisht banorë të Bashkimit European realizohet nga Direktiva 2003/86. Kjo Direktivë është miratuar më 22 Shtator 2003 dhe synon harmonizimin e legjislacioneve kombëtare duke garantuar të drejtën e fjalës.

Ajo e trajton të drejtën familjare jo vetëm si një të drejtë themelore, por edhe si faktor i promovimit të qëndrueshmërisë social-kulturore të emigranteve dhe të integritetit të tyre në shtresat sociale të shtetit pritës. Direktiva njeh të drejtën për bashkim familjar si një të drejtë subjektive të pranuar dhe njohur nga të gjitha shtetet anëtare.

Në tekstin e direktivës trajtohet përmbajtja progresiste duke iu referuar veçanërisht kufizimeve të familjarëve të pranuar në bashkim familjar. Këto pjesë të kësaj direktive do të paraqiten në këtë punim/studim.